



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 639 Prot.

Tiranë, më 04.09.2026

NJOFTIM

PËR ZHVILLIMIN E AUDICIONIT PËR ZËRAT E RINJ PËR PRODUKSIONET E SEZONIT ARTISTIK 2026-2027 TË TKOBAP-SË

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, ligjit nr. 75/2019 “Për rininë”, Statutit dhe Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin për zërat e rinj për produksionet e sezonit artistik 2026-2027 i cili do të mbahet më 28.09.2026, ora 13:00, në Hollin e Katit të Dytë të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor.**

Pjesëmarrësit duhet të paraqiten me tre arie të epokave dhe stileve të ndryshme të përzgjedhura sipas dëshirës së tyre. Ariet duhet të jenë të repertorit operistik, përkatësisht nga kompozitorë si: V. Bellini, G. Donizetti, A. Boito, G. Bizet, W. A. Mozart, G. Verdi, G. Puccini, G. Rossini, P. Mascagni, L. Cavallo, C.W. Gluck, C. Gounod, R. Wagner, C. Ma. Weber, U. Giordano, J. Massenet etj.

Pjesëmarrësit do i nënshtrohen edhe leximit me shikim të parë (A prima vista).

Të interesuarit duhet të dërgojnë në e-mail-in zyrtar të TKOBAP-së, sekretaria@tkob.gov.al, jetëshkrimin e tyre (CV-në) deri më 25.09.2026 dhe po nga e njëjta adresë do të marrin edhe konfirmimin e pjesëmarrjes ose jo të tyre në audicion.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aulon Naci

